

Sipas dispozitave të Rregullores së UNMIK-ut Nr. 2001/35, mbi Pensionet në Kosovë, të datës 22 Dhjetor 2001,

Me qëllim të ekzekutimit të Nenit 14.11 dhe Nenit 21.7 të Rregullores së UNMIK-ut Nr.2001/35, dhe parashkrimin e vlersimit aktuarial të skemës së Pensionit me Benefit të Definuar dhe themelimin e standardeve aktuariale që do të shfrytzojnë për bërjen e këtyre vlersimeve aktuariale,

Bordi Drejtues i Autoritetit Bankar të Pagesave të Kosovës (BPK), në mbledhjen e tij të mbajtur më 23 tetor 2002 përshtat si vijon:

Rregulla 15 mbi Financimin dhe Vlersimin aktuarial të Rregullimit Pensional me Benefit të Definuar

Neni 1

1.1 Sfera e Rregullës

Kjo Rregull i adresohet ofruesve të Pensionit Pundhënës Suplementar (“Fondi i Pensionit”) dhe kompanive të Sigurimit Jetsor (Siguruesi i Pensionit) që sponzorojnë rregullimin Pensional me Benefit të Definuar në Pensionin Individual Suplementar. Bankat dhe institucionet tjera financiare, si Sigurues të Pensionit, ndodhë që nuk mundë të ofrojnë program të Pensionit me Benefit të Definuar.

Kjo Rregull gjithashtu i adresohet Staticientit (ekspertit) që llogarit, konkludon ose vërteton Raportin e Vlersimit Aktuarial në lidhje me skemën e Pensionit me Benefit të Definuar.

1.2 Qëllimi i Rregullës

Kjo Rregull parashkruan kërkesat e financimit të Pensionit me Benefit të Definuar dhe themelon standardet minimale që do të zbatohen nga eksperti për pregaditjen dhe kompletimin e Raporteve Relevante të Vlersimit Aktuarial.

Neni 2

Dispozitat e përgjithshme

2.1 Definimet

Të gjitha termet e shfrytzuara në këtë Rregull janë ashtu siq janë definuar dhe përcaktuar në Rregulloren e Pensionit dhe/ose siq definohe në këtë Rregull.

“Actuary” (ekspert i sigurimeve) nënkupton një individ i cili bazuar në shkollimin e asaj apo atij, trajnimin dhe përvojën, është zotuar që të posedoj shkathhtësit në bërjen e llogaritjeve matematikore në lidhje me vlersimin dhe financimin e programit të Pensionit me Benefit të Definuar që punon për vetveten ose për ndonjë firmë, dhe i cili është i njohur nga BPK-ja si ekspert i kualifikuar për pensione.

“Raporti aktuarial” ose “Raporti i vlersimit aktuarial” nënkupton raportin që tregon mjetet dhe detyrimet, dhe kërkesat e financimit (kontributet) për Pensionin me Benefit të Definuar duke përfshirë metodat, supozimet dhe të dhënat e shfrytzuara në arritjen e konkluzioneve aktuariale, të përgatitura nën udhëheqjen dhe nënshkrimin e një Eksperti (Actuary).

“Mjete” nënkupton mjetet e rregullimit pensional, të vlersuara sipas Rregullës 6 të kësaj Rregulle.

“Detyrimet Aktuariale” nënkupton prej datës së veçantë të vlersimit të Pensionit me Benefit të Definuar, më të madhen e :

- a) Mundësisë se pagimit (“solvency liability”) ose
- b) Vlera prezente e Benefitit të Pensionit e shpërndarë për periodën menjëherë para datës së vlersimit në pajtim me metodat aktuariale të shfrytzuara për përcaktimin e Kontributit Normal.

“Gjendja vjetore financiare e revizionuar” përfshin Raportin e Mjeteve dhe Detyrimet qysh prej fundit të vitit financiar; raportin e kontributit, të hyrat dhe të dalurat për vitin që ka përfunduar në të njëjtin vit financiar dhe disa ekspoze të tjera, planet dhe shënimet e tjera, të përgaditura në mënyrë që të jetë në pajtim me Standardet Ndërkombëtare të Kontabilitetit.

“Deficiti” ose “deficiti i financimit” nënkupton shumën me të cilën detyrimi aktuarial i tejkalon mjetet e pensionit në datën e vlersimit.

“Viti Financiar” nënkupton periodën e 12 muajve në vijim që fillon në fillim të qdo Janari dhe përfundon qdo herë me 31 Dhjetor të qdo viti. Viti i tillë i parë financiar përfundon me 31 Dhjetor të vitit kur Urdhërsa e Pensionit ose Rregulla e Pensionit hyn në fuqi.

“Fondi” nënkupton shumën e mjeteve që janë segreguar për të mbështetur programin e Pensionit me Benefit të Definuar.

“Shkalla e financimit” nënkupton sasinë e mjeteve për detyrimet aktuariale.

“Plotsisht i financiar” ose “në kushte me financim të plotë” nënkupton kushtet financiare të rregullimit pensional ku mjetet e pensionit janë të barabarta ose më të larta se detyrimi aktuarial.

“Plani i financimit” nënkupton metodologjin e financimit (financimit) e të Drejtave të Rezervuara. Metodologjia e Financimit ose Themelimit e lejuar për pensionin me Benefit të Definuar është një “ngritje e vetme”(“single premium”) e aplikueshëme për periodën(et) e veqantë të viteve të fituara (akumuluar) të shërbimit.

“Kontributi normal” nënkupton shumën e kontributit që është i nevojshëm që të financoj vlerën prezente të benefiteve të pensionit që janë shpërndarë për vitet e veqanta në pajtim me metodën e vlersimit actuarial të shfrytëzuar.

“Para-plani i deficitit” nënkupton atë që pjesa e deficitit të krijuar në programin e Pensionit me Benefit të Definuar që ju takon viteve të kredituara të shërbimit të arritur që i atribuohet viteve të shërbimit para datës efektive të Urdhëresës së Pensionit dhe të përfshirë si Shërbim i Arritur në Raportin e parë të Vlersimit Aktuarial të pregaditur në pajtim me këtë Rregull.

“Deficiti i shërbimit të mëparshëm” nënkupton deficitin e themeluar në Fondin e Pensionit që ju takon viteve të kredituara të shërbimit të atribuueshme për periodat e shërbimit para ose në datën efektive të Urdhëresës së Pensionit. Me fjalë të tjera, termi nënkupton Deficitin më të vogël se deficitin e Para-planit e paraqitur (pjesa e palikuiduar).

“Sponsor” nënkupton Pundhënësin në Fondin Suplementar Pundhënës të Pensionit, ose Kompanin e Sigurimit Jetsor në Pensionin Individual Suplementar, që ofron skemën e pensionit me Benefit të Definuar.

“Mundësia e pagesës” (“solvency liability”) nënkupton, prej datës së veqantë të vlersimit të pensionit me Benefit të Definuar, më të lartën e:

- a). kontributeve të akumuluar të pjesmarrsit plus interesi, ose
- b). Vlera prezente e benefitit të pensionit e llogaritur nëse Fondi i Pensionit shuhet në datën e vlersimit actuarial me supozimin që secili pjesëmarrës është plotsisht i siguruar në Fond.

“Teprica” nënkupton tejkalimin e mjeteve të pensionit në detyrimet aktuariale.

Neni 3

Financimi i Rregullimit Pensional me Benefit të Definuar

3.1 Përgjegjësit e Sponzorit

Sponzori është përgjegjës për mirmbajtjen e rregullimit pensional në kushte plotsisht të financuara, ose nëse ky kusht nuk është plotsuar, gradualisht të bihet rregullimi pensional në kushte plotsisht të financuara. Sponzori duhet të sigurojë se kontributet që i referohen Nën seksionit 3.2 të këtij Seksioni janë depozituar në Fond për shumën (at) dhe brenda kohës së definuar në Urdhëresat e Pensionit ose Rregullat e Pensionit dhe në pajtim me Raportin Aktuarial të parashkruar në Nenin 4 të kësaj Rregulle.

3.2 Përmbushja e përgjegjësi të financimit

Në mënyrë që të përmbushen kërkesat e rregullimit pensional me Benefit të Definuar, Sponzori duhet të bëjë pagesën për Fond për:

- a) Kontributi normal për dhe në emër të pjesmarrësit sikur që është përshkruar në Urdhëresën e Pensionit ose Rregullat e Pensionit në pajtim me kërkesat e Vlersimit Aktuarial të aplikuar.
- b) Kontributi plotsues i nevojshëm që të financoj dhe mbuloj deficitin në Fond në lidhje me deficitin e Para-planit, ose deficitin e Shërbimit të mëhershëm.

3.3 Kualiteti i financimit

Entiteti i Pensionit që implementon programin e pensionit me Benefit të Definuar duhet të raportojë në BPK kualitetin e financimit të pensioneve të tyre, ku fajlojnë raportet e tyre vjetore, Raportet e tyre Aktuariale dhe qfardo që kërkohet prej BPK-s. Kualiteti i financimit përfshin ndonjerën prej këtyre klasave:

- a) Klasa A, mjetet e pensionit janë të barabarta ose më shumë se detyrimet aktuariale (plotsisht i financiar).
- b) Klasa B, mjetet e pensionit janë më pak se detyrimet aktuariale mirpo janë të barabarta ose më shumë se obligimet e pagimit (“solvency liability”).
- c) Klasa C, mjetet e pensionit janë më pak se “Solvency liability”

3.4 Determinimi i kualitetit të fondit

Në determinimin e kualitetit të fondit, është e nevojshme për Entitetet e Pensionit që të krahasojmë mjetet e pensionit ndaj dispozitave të themeluara si detyrime aktuariale dhe “solvency liability”. Vlera e mjeteve të Pensionit që duhet të shfrytzohe në këtë krahasim duhet të jetë vlera totale e mjeteve të pensionit sikur që është treguar në gjendjen e fundit financiare vjetore të revizionuar dhe/ose raporti i portofoliove të investimit nga data e njëjtë e vlersimit si detyrimet.

3.5 Financimi i deficitit

- a) Deficiti i Para-planit. Deficiti i Para-planit i krijuar në Raportin e parë të Vlersimit Aktuarial të programit të pensionit me Benefit të Definuar duhet të financohet me kontribute plotsuese mujore të barabarta brenda periodës jo më të shkurtë se 60 muaj prej datës efektive të Urdhëresës së Pensionit.
- b) Deficiti i Shërbimit të Mëparshëm. Deficiti i Shërbimit të Mëhershëm në programin e pensionit me Benefit të Definuar duhet të financohet me kontribute plotsuese mujore të barabarta brenda periodës prej 12 muajsh prej kohës që është themeluar në Raportin e Vlersimit Aktuarial.
- c) Shuma e kontributeve plotsuese mujore për të financuar deficitin financues duhet të determinohet dhe fiksohet ashtu që vlera prezente e serisë së kontributeve plotsuese mujore të kërkuara gjatë periodës financuese është e barabartë me deficitin për të cilin bëhet fjalë.
- d) Harmonizimi i kontributeve plotsuese mujore. Në Raportin e Vlersimit Aktuarial që pason, shuma e kontributeve plotsuese mujore për të financuar deficitin mundë të rillogariten dhe rregullohen ashtu që të përputhen me kërkesat e nenit c, më lartë.
- e) Përfundimi i kontributeve mujore. Nëse Vlersimi pasues Aktuarial tregon Tepricë, kontributet plotsuese mujore që kanë mbetur mundë të përfundohen. Përveq kësaj, nëse Teprica është më e lartë se 20 % të detyrimeve aktuariale, atëherë Teprica mundë të shfrytëzohet si kontribut normal i Pundhënësit dhe nëpunësit në proporcion të shkallës së ndarjes së tyre për kontributet normale.

Neni 4

Standardet e Vlersimeve Aktuariale

4.1 Raporti i Vlersimit Aktuarial

Qdo sigurues i pensionit me Benefit të Definuar duhet të bëjë raportin e vlersimit aktuarial të rregullimit të tij pensional dhe ta dorzojë në BPK Raportin korrespondues të Vlersimit Aktuarial të pregaditur në mënyrën e parashkruar sipas kësaj Rregulle. Vlersimi Aktuarial kërkohet prej datës efektive të Urdhëresës së Pensionit ose Rregullës së Pensionit të rregullimit të Pensionit me Benefit të Definuar, dhe

- a) Në mënyrë vjetore, në fundë të vitit financiar të Fondit të Pensionit me më shumë se 1.000 pjesmarrës.
- b) Qdo pesë vite prej këtu, në fundë të qdo viti të pestë financiar të Fondit të Pensionit me 1000 ose më pak pjesmarrës.

- c) Në mënyrë vjetore, në fundë të vitit financiar të kompanisë së sigurimit jetsor që ofrojnë për programin e pensionit me Benefit të Definuar.

4.2 Përmbajtja e Raportit të Vlersimit Aktuarial

Raporti i Vlersimit Aktuarial duhet të përmbaj si vijon:

- a) Raportet e Ekspertit duhet të përmbajnë si vijon:

1. Gjendjen që të dhënat e marra dhe të shfrytzuara nga Eksperti janë për njohurinë e asaj apo atij complete dhe të llogaritura me qëllim të pregaditjes dhe kompletimit të Raportit dhe të dhënat janë nënshtruar testit për arsyeshmërinë dhe qëndrueshmërinë e tij në relacion me rregullimin pensional.
2. Gjendjen që Raporti:
 - (ii) Përputhet me kërkesat e Rregullores së Pensionit dhe këtë Rregull.
 - (iii) A është pregaditur duke u bazuar në kriteret e Urdhëresës së aplikueshmë të Pensionit ose Rregullës së Pensionit.
 - (iv) Supozimet e shfrytzuara janë në pajtim me principet e pranueshme të vlersimit të pensionit dhe me standardet që zbatohen për rregullimin pensional.
 - (v) Metodot e zbatuara në llogaritje janë në pajtim me principet aktuariale të shëndosha dhe të përgjithshme dhe të pranueshme të përshtatura nga Asociacioni Ndërkombtar i Ekspertave, dhe i njohur sipas Standardeve Ndërkombtare të Kontabilitetit.
3. Konfirmimi dhe konkluzionet për shumën e mjeteve të pensionit, detyrimeve aktuariale, detyrimeve të pagimit (“solvency liability”), teprica ose deficitit, dhe kualiteti i fondit prej të njëjtës datë të vlersimit.

Llogaritjet dhe përfundimet mbi:

- (i) Mjaftueshmërinë e shumës së kontributit normal i cili duhet të paguhet për vitet financiare që pasojnë, i ndarë në kontributet që janë paguar nga pjesmarrësi dhe kontributet që janë paguar nga Sponzori.

- (ii) Mjaftueshmëria e formulës në llogaritjen e shumës së kontributit normal që do të paguhet për periodën (at) ose vitet deri në Vlersimin e ardhshëm Aktuarial.
4. Llogaritja dhe konfirmimi i mjaftueshmërisë së shumës së kontributeve plotsuese mujore që është e nevojshme të financojë dhe ngre deficitin, nëse ka.
- b) Supozimet dhe informimet në të cilat është bazuar pregaditja e Raportit të Vlersimit Aktuarial.
 - c) Qështjet e tjera që mundë të parashkruhen nga BPK-ja.

4.3 Kërkesat tjera plotsuese

Raporti i Vlersimit Aktuarial duhet të shoqrohet me si vijon:

- a) Deklaratën nga një oficer i autorizuar i Fondit të Pensionit ose Sigurues i Pensionit që vërteton se shënimet dhe Urdhëresat e Pensionit ose Rregullat e Pensionit e dhëna për Ekspertin janë complete dhe të sakta.
- b) Vendimi nga trupat më të lartë drejtues të Sponzorit që konfirmojnë se Sponzori kupton kualitetin e financimit të rregullimit Pensional. Në rastin e Fondit të Pensionit, deklarata që e riafirmon mundësinë e Pundhënësit për të dhënë kontributet e Pundhënësit në pajtim me shumën dhe fazën e caktuar në Deklaratën e Ekspertit.
- c) Raporti i Vlersimit Aktuarial duhet të përmbajë nënshkrimet e Ekspertit dhe oficerin e autorizuar të Sponzorit, duke përfshirë këto entitete të Fondit të Pensionit, në rastë të Fondit Pensional Pundhënës Suplementar.
- d) Qështjet tjera që mundë të kërkohen nga BPK-ja.

4.4 Përgjegjësit fiduciare të Ekspertit

Bërja e llogaritjeve, konfirmimeve dhe konkluzioneve nga ana e Ekspertit për Raportin e Vlersimit Aktuarial është detyrë fiduciare e Entitetit të Pensionit dhe pjesmarrësve. Nëse Raporti Aktuarial i Vlersimit ose Raporti i Ekspertit dëshmon që nuk është në pajtim me kërkesat e Rregullores së Pensionit, ose nëse vlersimi aktuarial nuk është bërë në pajtim me principet aktuariale të përgjithshme të shëndosha të pranueshme:

- a) Trupi më i lartë i Entitetit të Pensionit do të pengohet në emrimin e ekspertit të njëjtë që të zhvilloj Raportin e Vlersimit Aktuarial ose të gjeneroj një Raportë të Ekspertit për periodën pasuesë të vlersimit.

- b) Entiteti i Pensionit mundë të padit Ekspertin që të përmirsoj dëmtimin që vuan aktualisht për shkak të Vlersimit Aktuarial të gabuar ,përveq të gjitha masave ligjore të ofruara në Rregulloren e Pensionit, Rregullat ose ligjet tjera.

Neni 5
Hyrja në fuqi

Kjo Rregull do të hyj në fuqi më 23 tetor 2002.

Drejtori i Përgjithshëm